



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3394/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>26-09-2014</u>
Nr. pages	
PRISTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.09.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2182/14, për z. Kolë Prenaj – Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Klinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2182/14, për z. Kolë Prenaj – Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Klinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Prenaj është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Komunën e Klinës dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesin privat, N.P.T. “AGROKLINA - KO”.

Zyrtari në fjalë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, është takuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Prenaj, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të emëroj një person të besueshëm për të menaxhuar biznesin privat, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj në afatin e caktuar nga Agjencia.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 3214/14) me të cilën vërtetohet se në biznesin privat është emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar. Me këtë është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesit.

**II.** Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

